



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obština-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Risamont shpk” të datës 15.08.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Instalimi i elektrikes – Ndërtimi i trafoblindës për kopshtin në Kolovicë” me nr. të prokurimit 616-26-5595-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. MIRATOHET si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Risamont shpk” të datës 15.08.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Instalimi i elektrikes – Ndërtimi i trafoblindës për kopshtin në Kolovicë” me nr. të prokurimit 616-26-5595-5-2-1 ashtu që ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Risamont shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 15.08.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Instalimi i elektrikes – Ndërtimi i trafoblindës për kopshtin në Kolovicë” me nr. të prokurimit 616-26-5595-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Pika 1: Mos-përputhja kritike e pajisjes (Kriteri: "Paisje, instrument për injektim të rrymave deri 100 A")

- Dështimi Material i OE "VOLTECHZ" SHPK: Ky operator ka dorëzuar fletë teknike për pinca ampermetrike të thjeshta (*Benning CM 10-1, UNI-T*) dhe një analizator rrjeti (*Suin*). Të gjitha këto janë instrumente pasive të matjes (leximit) të rrymës ekzistuese në një kabllo përmes fushës magnetike. Asnjëra prej tyre nuk ka gjenerator të brendshëm për të injektuar (detyruar/prodhuar) rrymë artificiale prej 100 A në një qark. Kjo shkel direkt Nenin 59.4 (i) të LPP-së, pasi pa pajisje injektimi nuk mund të testohet mbrojtja rele dhe ndërprerësit e trafoblindës [59.4].
- Përputhshmëria e Plotë e "RISAMONT" SH.P.K.: Kompania jonë ka dorëzuar sistemin e mirëfilltë industrial të injektimit të rrymës primare Megger INGVAR, i cili ka kapacitet injektimi të rrymës alternative deri në 5000 A (shumë më tepër se limiti minimal prej 100 A i kërkuar). Kemi ofruar gjithashtu aparatin Megger TRAX 220 i cili gjeneron dhe injekton rrymë direkte prej saktësisht 100 A DC (True DC), të verifikuar me Certifikatë Kalibrimi zyrtar lëshuar nga prodhuesi më 28.02.2025.

Pika 2: Inxhinieri i paçertifikuar për pajisje matëse (Kriteri: "Inxhinier të çertifikuar me licens A, për energji të jetë I çertifikuar për përdorimin e paisjeve matëse")

- Dështimi i OE "VOLTECHZ" SHPK: Për inxhinierin e propozuar (z. Imri Zejnullahu), ky OE ka prezantuar vetëm një CV narrative dhe një Licencë A të përgjithshme inxhinierike të Odës. Licenca A tregon vetëm të drejtën ligjore për projektim/mbikëqyrje ndërtimi, por nuk përbën certifikim trajnimi për përdorim instrumentesh matëse. Kjo shkel Nenin 41 të RRPP-së. Pretendimi në CV se është i licencuar nga MTI është i pavlerë, pasi dokumenti fizik i MTI-së nuk gjendet në ofertë.
- Përputhshmëria e Dyfishtë e "RISAMONT" SH.P.K.: Kompania jonë ka dorëzuar dëshmi formale për dy inxhinierë të trajnuar direkt nga prodhuesit lider botërorë:
 1. Për inxhinierin z. Arben Fejzullahu (Master i Shkencave, Licenca A E-0229) janë dorëzuar certifikatat ndërkombëtare të trajnimit nga gjiganti OMICRON Academy (Gjermani) për përdorimin e platformës komplekse matëse CPC 100 për matjen e sistemeve të tokëzimit, impedancave të linjave dhe transformatorëve të fuqisë.
 2. Për inxhinierin z. Hesat Guri kemi dorëzuar Certifikatën Zyrtare nga kompania BELMET MI d.o.o. (Slloveni) që vërteton trajnimin e plotë për instrumentin profesional METREL EUROTTEST 61557 (sipas standardit EN 61557).

Pika 3: Trajnimi online "Alison" nuk përbën certifikim të mirëfilltë (Kriteri: "Inxhinier I çertifikuar me standardin ISO 50001:2015")

- Dështimi i OE "VOLTECHZ" SHPK: Ky operator ka dorëzuar një fletë pjesëmarrjeje të shkarkuar online nga platforma masive e hapur Alison për një kurs 40-orësh "Internal Auditor". Komisioni ka gabuar duke e marrë këtë si certifikim të mirëfilltë. Standardi ISO 50001 kërkon një Certifikim Personal (Personal Certification) të akredituar zyrtarisht sipas standardit ISO/IEC 17024 (nga trupa si

TUV, AQSCERT, SGS, etj.), i cili i nënshtrohet provimeve të rrepta. Një kurs online i paakredituar, pa kod unik shtetëror auditimi, nuk dëshmon certifikim të mirëfilltë inxhinierik të standardit.

- Përputhshmëria e Mirëfilltë e "RISAMONT" SH.P.K.: Kompania jonë ka dorëzuar Certifikatën Zyrtare Profesionale të Inxhinierit z. Malush Muslija (Nr. AOS/T/S155312026), të lëshuar nga Organizmi i Akredituar i Vlerësimit të Konformitetit AQSCERT. Ky është një certifikim zyrtar i strukturuar për standardin e ri ISO 50001:2018 si Auditor i Sistemeve të Menaxhimit të Energjisë, i cili mban të specifikuar numrin e diplomës së inxhinierisë (Diploma Nr. 395) dhe është plotësisht i verifikueshëm në regjistrat zyrtarë (www.aqscert.org/certifikata).

Kërkesa për rishqyrtim është miratuar si pjesërisht e bazuar sa i përket kërkesës për certifikim të stafit përkatësisht inxhinierit me licens A dhe inxhinierit me ISO 500001:2015, ashtu që komisioni për rivlerësim duhet të vlerësoj edhe njëherë nëse këto kërkesa janë përmbushur nga tenderuesi i rekomanduar sipas kërkesave specifike të DT ose jo.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.08.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.